



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni i Posaçëm për Reformën në Sistemin e Drejtësisë

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 02.04.2015, ora 12:30

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 23.01.2015
2. Informimi i anëtarëve të Komisionit mbi ecurinë e Fazës së I-rë të procesit në zbatim të vendimeve të marra në mbledhjen e Komisionit të datës 23.01.2015
3. Projektvendim nr. 9 "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.7 dt.23.01.2015 të Komisionit të Posaçëm "Për miratimin e Grupit të Ekspertëve të Nivelit të Lartë pranë Komisionit të Posaçëm Parlamentar".
4. Projektvendim nr.10 "Për miratimin e ekspertëve si konsulentë të jashtëm pranë Komisionit të Posaçëm Parlamentar".
5. Projektvendim nr.11 për miratimin e Strukturës së Dokumentit Strategjik, Planin e Veprimit për Zhvillimin e Strategjise si dhe Masat Legjislative dhe propozimet konkrete"
6. Projektvendim nr.12 "Për ngritjen dhe drejtimin e Grupeve të Punës në përbërje të Grupit të Ekspertëve të Nivelit të Lartë dhe Sekretariatit Teknik pranë Komisionit të Posaçëm "Për reformën në sistemin e drejtësisë"

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Pandeli Majko, Spartak Braho, Ulsi Manja, Vasilika Hysi dhe Armando Subashi.

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Përsëhendetje!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë. Janë të pranishëm të gjithë anëtarët.

Desha t'ju informoj shkurtimisht lidhur me punën e deritanishme të Ekspertëve të Nivelit të Lartë dhe Sekretariatit Teknik.

Në zbatim të vendimeve nr 7 dhe 8 dt.23.01.2015 të Komisionit të Posaçëm Parlamentar “Për reformën në sistemin e drejtësisë, është ngritur Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë dhe Sekretariati Teknik, të cilët janë shpërndarë dhe janë organizuar në 7 grupe pune si më poshtë:

Grupi për Amendimet Kushtetuese dhe Gjykatën Kushtetuese

Grupi për Reformën në Sistemin Gjyqësor

Grupi për Reformën në Drejtësinë Penale

Grupi për Edukimin Juridik Universitar dhe Shkollën e Magjistraturës

Grupi për Institucionet e Shërbimeve Ligjore

Grupi për Strategjinë dhe Planin e Veprimit Antikorrupsion

Grupi për Financimin e Drejtësisë

Grupet e punës, përveç ekspertëve të nivelit të lartë kanë në përbërje të tyre, përfaqësues të Sekretariatit Teknik në radhët e stafit jurist/këshilltarë të Kuvendit, Ministrisë së Drejtësisë, Gjykatës Kushtetuese, Gjykatës së Lartë, Fakultetit të Drejtësisë dhe Asistencës Ndërkombëtare.

Në kuadër të fazës së parë të procesit, Grupet e Punës kanë administruar dhe analizuar informacione, materiale, analiza apo studime të përcjella nga institucione të ndryshme si: Ministria e Drejtësisë, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Integritit, Prokuroria e Përgjithshme, Avokati i Popullit dhe Këshilli i Lartë i Drejtësisë si dhe disa gjykata lidhur me infrastrukturën apo numrin e çështjeve.

Secili Grup Pune, sipas objektit të veprimtarisë që ka në fokus dhe në kuadër të Fazës së I-rë të analizës së sistemit të drejtësisë dhe rishikimit të dokumentit analitik të Ministrisë së Drejtësisë, me qëllim për ta pasuruar më tej këtë dokument me analiza dhe problematika, ka finalizuar dokumentin e analizës në fushat që mbulon.

Aktualisht dokumentat janë integruar në një material përmbledhës i cili do të përbëjë dokumentin bazë të Analizës së Sistemit të Drejtësisë, të cilin ja u kam dërguar sot Ekspertëve të Nivelit të Lartë.

Ky dokument do të jetë objekt diskutimi në tryeza të rrumbullakta, me përfaqësues të institucioneve të sistemit të drejtësisë, Presidencës, Ministrisë së Drejtësisë, trupës pedagogjike dhe organizata të shoqërisë civile dhe do t'i nënshtrohet një konsultimi të gjerë nëpërmjet portalit online, për t'u finalizuar me shqyrtimin nga Komisioni i Posaçëm.

Ekspertët janë duke punuar shumë mirë. Ju informoj gjithashtu se kam pasur takime me disa ambasadorë, vecanërisht me ambasadorin e BE-së Vlahutin dhe ambasadorin Amerikan Lu, i cili sapo të dalë produkti përfundimtar i Analizës do të vijë në Komision.

Ka një gjë shumë pozitive që ma kanë theksuar edhe ata, që ekspertët nuk i kemi caktuar ne, por janë caktuar nga institucionet dhe qëndrimi ynë ka qënë që reformën do ta bëjnë ekspertët.

Pas datës 15 prill në do të organizojmë disa tryeza lidhur me dokumentin e analizës.
Ju kam dërguar disa modele, dhe struktura e strategjisë është e konsultuar edhe me Euraliusin. A jemi dakord që të fillojë puna me strategjinë? Dakord.

Ju lutem ti shikoni dhe nëse do të kini dicka mund të rregullohen pasi janë thjesht struktura.

Deri në fund të prillit do të kemi një draft strategji.

Ulsi Manja – Opozita nuk do që të marrë pjesë apo ka ndonjë vërejtje?

Fatmir Xhafaj – Opozita nuk ka hyrë. Vazhdojmë, a jemi dakord me ekspertët e propozuar nga Komisioni i Venecias, z.James Hamilton dhe z.Luan Omari, si ekspert të Nivelit të Lartë? Dakord. Miratohet. Jemi dakord me miratimin si ekspertë të Nivelit të Lartë, të ekspertëve ndërkombëtarë të Misionit Euralius, znj.Agnes Bernhard, Richard Regner dhe Koraljka Bumci? Dakord. Miratohen. Jemi dakord me zëvendësimin e z.Artur Selmani nga z.Dritan Reshka me propozim të Prokurorisë së Përgjithshme? Dakord. Miratohet.

Fatmir Xhafaj – Dakord. Vazhdojmë me projektvendimin për disa ekspertë si konsulentë të jashtëm.

Spartak Braho – Unë propozoj të shtohet edhe z.Perikli Zaharia si ekspert.

Fatmir Xhafaj – Jemi dakord me këtë propozim? Dakord. Miratohet.

E mbylлим mbledhjen. Ju faleminderit.

MBLEDHJA MBYLLET

Sekretare

Vasilika Hysi

Përgjegjëse e Sektorit të Redaktorëve

Euzheni Pengili